



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 20 qershor 2013

Nr. i lëndës 2012-09, 2012-10, 2012-11 dhe 2012-12

A, B, C dhe D

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, përmes mjeteve elektronike, në përputhje me rregullën 13 të rregullores së punës më 20 qershor 2013 me anëtarët e paraqitur si në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesat A, B dhe C ishin regjistruar më 12 korrik 2012, përderisa ankesa D ishte regjistruar më 17 korrik 2012.
2. Paneli ka miratuar kërkesën e ankuesve që emrat e tyre mos të zbulohen, bazuar në shqetësimet që ata kanë lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e tyre.

3. Më 4 dhjetor 2012, Paneli ka komunikuar ankesat tek shefi i misionit (ShM) i EULEX-it në Kosovë dhe e ka ftuar atë të parashtroj vërejtje me shkrim rreth ankesave. Paneli ka komunikuar ankesat A, B, C dhe D së bashku, pa e paragjykuar opsionin që më vonë të urdhërohet një bashkim formal i këtyre lëndëve sipas rregullës 20 të rregullores së vet të punës.
4. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 11 mars 2013 pas së cilës ato janë përkthyer dhe komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë nga ta. Ankuesit nuk kanë bërë ndonjë vërejtje tjetër.
5. Më 18 mars 2013, Paneli ka ftuar ShM që të parashtroj ndonjë vërejtje tjetër që ai mund të ketë rreth meritave të lëndës. ShM ka ofruar parashtime gjithëpërfshirëse me 8 prill 2013.
6. Më 10 prill 2013, Paneli ka urdhëruar bashkimin formal të të gjithë katër lëndëve (A, B, C dhe D) sipas rregullës 20 të rregullores së vet të punës. Në të njëjtën ditë, Paneli ka shpallur këto ankesa të pranueshme dhe ka gjetur se, sipas parashtimeve të palëve, ankesat kanë ngritur çështje serioze të faktit dhe ligjit sipas nenit 2 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj)/neni 6 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KEDCP), neni 3 KEDNj/neni 7 KEDCP, neni 5 KEDNj/neni 9 KEDCP), neni 8 KEDNj/neni 17 KEDCP, neni 9 KEDNj/nenet 18 dhe 19 të KEDCP, neni 10 të KEDNj/neni 19 KEDCP, neni 11 KEDNj/nenet 21 dhe 22 KEDCP, neni 13 KEDNj/neni 2 KEDCP dhe neni 14 KEDNj/nenet 26 dhe 27 KEDCP, përcaktimi i të cilave kërkon një shqyrtim të meritave të ankesave.
7. Paneli ka ftuar ShM të paraqesë vërejtje shtesë mbi meritat e lëndës jo më vonë se 19 prilli 2013, e që ishte shtyrë deri më 14 maj. Ankuesve ju ishte dhënë kohë deri më 2 maj 2013 për t'u përgjigjur dhe komentuar mbi ndonjë çështje të re të ngritur nga ana e ShM në vërejtjet e tij. Asnjë vërejtje tjetër nuk ishte marrë nga ankuesit.
8. Më 4 qershor 2013, Paneli ka marrë dokumentacion shtesë nga ShM. Shumica e informacionit të marrë ka të bëjë me aspektet organizative dhe administrative të përfshirjes së EULEX-it në festimet e Vidovdanit më 28 qershor 2012. Pasi që informacioni i dhënë ishte i karakterit të përgjithshëm dhe nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë me lëndët A, B, C dhe D, dhe për shkak të natyrës së tij konfidenciale, Paneli ka vendosur që mos t'ua dërgoj këtë informacion ankuesve. Paneli nuk do të mbështetet në ndonjë aspekt të atij materiali që mund t'i dëmtoj kërkesat e ankuesve.

FACTS

Të dhëna paraprake

9. Vidovdani prej kohësh konsiderohet si një datë e një rëndësie të veçantë për serbët etnikë dhe për ata në Ballkan. Është një festë fetare serbe, dita e shën Vitusit, e cila është e lidhur në kulturën serbe me betejën e Kosovës kundër Perandorisë Osmane më 28 qershor 1389. Kjo ditë feste është e shenjtë për serbët etnikë dhe përkujtohet përmes ngjarjeve të veçanta që zhvillohen në Vidovdan, e cila bie çdo vit më 28 qershor. Përderisa atje nuk duket të ketë ndonjë informacion zyrtar rreth numrit të njerëzve që ndjekin ato ngjarje të përvitshme, vlerësimet tregojnë se në festimet në *Gazimestan* më 28 qershor 2012 kanë marrë pjesë disa mijëra persona.

Rrethanat e lëndës

Faktet e mëposhtme janë vendosur në bazë të informatave që ankuesit i kanë ofruar Panelit:

Ankuesi A

10. Ankuesi ka kërkuar që emri i tij/saj mos të bëhet publik, për shkak të frikës për sigurinë e tij/saj. Ai/ajo do të referohet si "A".
11. Më 28 qershor 2012, ankuesi, i cili punon si taksist, po e dërgonte një udhëtar në *Gazimestan*, aty ku udhëtari dëshironte të merrte pjesë në festimet e Vidovdanit.
12. Duke u kthyer nga rruga kryesore drejt *Gazimestanit*, "A" ishte ndaluar nga Policia e Kosovës (PK), ku fillimisht nuk i dha leje të vazhdoj drejt *Gazimestanit*. Pas bisedave në mes udhëtarit dhe PK-së, ankuesi ishte lejuar të vazhdoj udhëtimin e tij.
13. Menjëherë pas kësaj, përderisa i afrohej *Gazimestanit*, ankuesi ishte ndaluar nga Njësia Rajonale për Mbështetje Operative (NJRMO), njësi e specializuar policore përgjegjëse, *ndër të tjera*, për kontroll të turmës. Sipas "A" katër ose pesë zyrtarë të NJRMO-së ishin të pranishëm në atë rast. Ata i kanë bërë titur "A" dhe udhëtarit, i kanë fyer ata dhe i kanë kontrolluar dokumentet e identifikimit, lejen e veturës dhe regjistrimin e veturës së ankuesit. Pretendohet se zyrtarët e NJRMO-së e kanë pyetur "A" "prej cilës republikë po vinte". Gjithashtu pretendohet se ata ia kanë fyer nënën e "A".
14. Pas kontrollimit të dokumenteve të "A" dhe të udhëtarit, zyrtarët e NJRMO-së kanë kontrolluar makinën, mirëpo nuk kanë gjetur asgjë me interes. Rrjedhimisht, zyrtarët e NJRMO-së kanë udhëzuar ankuesin "ta kthej makinën dhe të zhduket". Sipas "A", zyrtarët policor të EULEX-it kanë qenë të pranishëm gjatë këtyre incidenteve, kishin vëzhguar se çfarë po ndodhte dhe nuk kishin ndërhyrë. Ankuesi nuk

ishite në gjendje të jepte ndonjë numër të përafërt të zyrtarëve policor të EULEX-it të pranishëm në vendngjarje.

15. Ankuesi ka deklaruar se në mënyrë që ta kthej makinë ashtu siç ishte udhëzuar nga zyrtarët e NjMRO-së, së pari ai duhej të voziste drejt Vushtrrisë, në mënyrë që të ketë hapësirë të mjaftueshme për tu kthyer, pasi skajet e rrugës ishin të bllokuara me pengesa. Pas kthimit të veturës dhe kthimit drejt Prishtinës, "A" ishte ndjekur nga një makinë e NjMRO-së, që i kishte ndezur dritat e saj sinjalizuese. Ankuesi kishte menduar se zyrtarët e NjMRO-së donin ta tejkalonin, kështu që si rrjedhojë ai lëvizi makinën e tij në skajin e rrugës. Në këtë pikë, zyrtarët e njëjtë të NjMRO-së, të cilët më herët e kishin ndaluar "A" ndaluan makinën e tyre përpara makinës së "A" dhe i kërkuan atij përsëri dokumentet. Në të njëjtën kohë, zyrtarë të tjerë të NjMRO-së kanë sulmuar udhëtarin në automjetin e "A".
16. "A" ka pretenduar se pastaj tre zyrtarë të NjMRO-së e dërguan atë mbrapa një makine të policisë, ku e goditën atë me shuplaka dhe shkelma. Sipas ankuesit, një zyrtar i katërt i NjMRO-së qëndronte jashtë makinës qëllimisht për të siguruar se askush nuk po e shihte sulmin. Sipas "A" sulmi kishte zgjatur rreth 10 deri 15 minuta. Si pasojë, "A" kishte pasur mavijosje në kokë, shpinë dhe stomak. Ankuesi pohon se kur ishte duke u larguar nga makina, një makinë e EULEX-it ka kaluar aty, mirëpo nuk është ndalur.
17. Pas kësaj, "A" u lejua që të largohej nga vendi i ngjarjes me udhëtarin, dhe zyrtarët e NjMRO-së i thanë që ta merrnin rrugën drejt Obiliqit. Më tej, thuhet se "A" dhe udhëtarit ju ishte thënë se zyrtarët e NjMRO-së nuk duan që përsëri të shohin makinën e tyre në afërsi të asaj zone dhe i kanë udhëzuar ata "të zhduken, sepse në qoftë se e shohin përsëri atë makinë do t'i rrahin [ata] përsëri".
18. Pastaj ankuesi ishte kthyer në Graçanicë. Ankuesi "A" në fillim ishte frikësuar të raportonte incidentin në polici. Xhaxhai i tij (mjek) më vonë e kishte bindur atë që të shkonte në polici dhe ta raportonte çështjen, të cilën ai e bëri. Në të njëjtën ditë, rreth orës 18:00, "A" shkoi në një spital për një kontroll mjekësor. Ankuesi i ka ofruar Panelit të dhëna mjekësore që tregojnë se ato ishin mavijosjeve në trupin e tij, të cilat janë në përputhje me raportin e tij të sulmit.

Ankuesit B dhe C

19. Këta ankues kanë kërkuar që emrat e tyre mos të bëhen publik për shkak të frikës rreth sigurisë së tyre. Ata do të referohen si "B" dhe "C".
20. Ankuesit "B" dhe "C" deklarojnë se ata ishin duke shkuar drejt Gazimestanit për të marrë pjesë në shërbimin përkujtimor për të shënuar festën serbe të Vidovdanit më 28 qershor 2012. Të dy ankuesit deklarojnë se policia e Kosovës e pranishëm në Gazimestan

ju kishte hequr këmishat pjesëmarrësve, të cilëve ju dukeshin simbolet dhe emblemat serbe.

21. Pretendohet se atëherë kur ankuesit ishin duke u kthyer prej Gazimestanit, afër stacionit të autobusëve të Prishtinës, aty ishin hedhur gurë dhe koktej molotovi nga djem të rinj në autobusët, në të cilët ata po udhëtonin, duke thyer dritaret e atyre autobusëve dhe duke vënë jetët e udhëtarëve në rrezik. Ankuesit pohojnë se dy udhëtarë ishin plagosën gjatë sulmit. Më tej, ankuesi "B" pretendon se ai/ajo e kishte humbur vetëdijen pas mbërritjes në Graçanicë për shkak të stresit të shkaktuar nga këto incidente. Ankuesi më pas ishte dërguar në spital për kontroll. Ankuesi "B" ka ofruar një raport mjekësor rreth mjekimit që ka marrë, e cila është në përputhje me raportin e tij/saj të incidentit.
22. Pretendohet se PK-ja i kishte shoqëruar autobusët nga Gazimestani për në Graçanicë, mirëpo nuk kishte arritur t'i mbrojë.

Ankuesi D

23. Ankesa është regjistruar më 17 korrik 2012. Sekretariati ka marrë informata shtesë nga ankuesi më 31 tetor të vitit 2012.
24. Ankuesi ka kërkuar që emri i tij/saj të mos bëhen publik për shkak të frikës rreth sigurisë së tij/saj. Ankuesi do të referohet si "D".
25. Më 28 qershor 2012, "D" shkoi në Gazimestan me një autobus shkolle, i cili po transportonte fëmijë të shkollës në ngjarjen përkujtimore të Vidovdanit. "D" punon si vozitës autobusi dhe mekanik. Në ditën në fjalë, ankuesi ishte në detyrë në autobus në cilësinë e mekanikut.
26. "D" ka pretenduar se ai ka parë shqiptarë të Kosovës në rrugën drejt Gazimestan, të cilët po shikonin se çfarë po ndodhte, mirëpo ai/ajo nuk kishte vërejtur "ndonjë provokim nga ta". Sidoqoftë, ai kishte vërejtur provokime nga NJMRO-ja dhe ka supozuar se zyrtarët e NJMRO-së i kanë keqtrajtuar udhëtarët atëherë kur ata po zbrisnin nga autobusët në Gazimestan. Zyrtarët e NJMRO-së kanë kërkuar nga vozitësit që t'i hapnin dyert e përparme të autobusëve në mënyrë që t'i kontrollonin udhëtarët kur ata po zbrisnin nga autobusët. Sipas ankuesit, zyrtarët e NJMRO-së "po ju zhvishnin fanellat me mëngë të shkurta që ishin me shenja serbe, dhe i hidhnin ato në tokë, i fshinin çizmet e tyre me to dhe i hidhnin ato në plehra". Më tej, është deklaruar se pastaj njerëzit ishin lejuar të vazhdonin rrugën e tyre me pjesën e sipërme të trupit të tyre lakuriq ose të pambuluar. Sipas "D" "policia e EULEX-it po shikonte gjithë këtë dhe nuk kishte reaguar aspak". "D" më tej shton se në atë kohë ka pasur një prani të madhe të policisë së EULEX-it në Gazimestan.
27. Ankuesi gjithashtu thotë se derisa ata po ktheheshin në Graçanicë pas ceremonisë, ishin hedhur gurë dhe kokteje molotovi në autobusët

në të cilët po udhëtonin ata. Kjo thuhet të ketë ndodhur pranë një vendi të quajtur TMK (UQK), në afërsi të hotelit Victoria në Prishtinë. Është pohuar se dy vetura civile kanë mbërritur në vendngjarje dhe janë ndalur përpara autobusit, duke ua bllokuar rrugën. "D" ka deklaruar se "në vendngjarje kanë qenë pesë djem të rinj rreth moshës 17 - 20 vjeç. Njëri prej tyre i cili hodhi një koktej molotovi në autobus e kishte fytyrën të mbuluar me një shall".

28. Supozohet se tre zyrtarë të policisë së Kosovës, të cilët po qëndronin disa metra larg nga vendi i ngjarjes, kanë qenë dëshmitarë të këtij veprimi. Sipas "D" "ata vetëm po qeshnin dhe nuk kishin ndërhyrë". Është pohuar se tre djem të rinj u lënduan gjatë incidentit në autobus, i cili zgjati rreth dhjetë minuta.
29. "D" ka ofruar fotografitë e autobusit, që ishin marrë pas incidentit. Këto fotografi kanë treguar dritare të thyera të autobusit, si dhe gurë në dyshemenë e autobusit. Kokteji i molotovit që thuhet se ishte hedhur në autobus nuk kishte shpërthyer në autobus, por përpara autobusit, në rrugë. "D" ka deklaruar se autobuset më në fund kishin arritur të vazhdonin udhëtimin, duke i dërguar personat e lënduar në klinikën më të afërt në Llapnasellë.
30. Pas një ndalje të shkurtër në Llapnasellë, autobusi ka vazhduar drejt Graçanicës. Në vend parkimin në Graçanicë, autobusi i ankuesit ishte ndalur nga PK-ja në mënyrë që ta fotografonin dhe regjistronin dëmin në autobus. "D" ka deklaruar se një prej zyrtarëve policor pyeti se pse ankuesi nuk e ka bërë ndonjë foto grafoi të incidentit, ku "D" ju ishte përgjigjur se më e rëndësishme ishte për të që të përdorte bombolën kundër zjarrit dhe të parandalonte zjarrin, i cili mund të kishte shkaktuar vdekjen e 50 udhëtarëve, shumica e të cilëve ishin fëmijë. "D" gjithashtu ofroj që të përshkruaj disa nga autorët, të cilëve "D" ju kishte parë fytyrat. Sipas ankuesit, zyrtari i policisë "vetëm se u kthye, bëri me dorë dhe u largua me automjet të policisë". "D" nuk është në dijeni që ka ndodhur ndonjë hetim lidhur me këtë rast.

Faktet që lidhen me përpjekjet hetimore të EULEX-it

31. Në vërejtjet e tij të datës 8 prill 2013, EULEX-i ka vërejtur një numër hapash hetimor të ndërmarra nga EULEX-i dhe/ose nga autoritetet kompetente të Kosovës në lidhje me disa nga ngjarjet që formojnë bazën e ankesave:
32. Prokurorët e EULEX-it nuk kanë hetuar ngjarjet në lidhje me ankuesin "A". Megjithatë, prokurorët e EULEX-it kanë hetuar çështjet e veçanta në lidhje me ngjarjet që kanë të bëjnë me ankesat e "B", "C" dhe "D".
33. EULEX-i ka deklaruar se një ekip i përzier prej një prokurori të EULEX-it dhe një prokurori vendor kanë hapur *ex officio* një hetim paraprak ndaj personave të panjohur, që dyshoheshin se ishin përfshirë në kryerjen e veprave penale të mëposhtme: Lëndim i lehtë trupor në kundërshtim me nenin 153, par. 2 në lidhje me par. 1 të

Kodit Penal të Kosovës (KPK), Lëndime të rënda trupore në kundërshtim të nenit 154 par. 1 i KPK, Dëmtimi i pasurisë së luajtshme në kundërshtim me nenin 260, par. 2 në lidhje me par. 1 të KPK-së dhe Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në kundërshtim me nenin 291, par. 1 të KPK-së.

34. Sipas informacionit të dhënë nga EULEX-i, më 28 qershor 2012, rreth orës 14:00 në Prishtinë, në afërsi të hotel "Victory", tre autobusë të shkollave me serbë të Kosovës që ktheheshin nga Gazimestan janë gjuajtur me gurë dhe mbi ta ishte hedhur koktejl Molotovi. Si pasojë, të tre autobusët ishin dëmtuar, ku ishin thyer disa dritare, 17 persona ishin plagosur, dhe dyshohet se 15 prej tyre kishin pësuar lëndime të lehta trupore, ndërsa dy prej tyre supozohet se kishin pësuar dëmtime të rënda trupore.
35. Sipas EULEX-it, hetimi i vendngjarjes së krimit ishte kryer nga hetuesit për krime të PK-së dhe një ekip mjeko-ligjor. Përkundër këtyre përpjekjeve, autorët e krimit nuk është mundur të identifikoheshin. Përveç kësaj, kontrollimi i kamerave CCTV përreth vendit të ngjarjes së krimit nuk ka prodhuar ndonjë rezultat konkret.
36. Më 4 korrik 2012, prokurori i EULEX-it e ka ngarkuar laboratorin e policisë mjeko ligjore për shqyrtimin e shisheve të gjetura në vendngjarje. Vlerësimi i provave të konfiskuara nuk kishte dhënë asnjë rezultat që do të kishte çuar në identifikimin e të dyshuarve të mundshëm. E njëjta gjë ka ndodhur me marrjen në pyetje të një numri të paidentifikuar të dëshmitarëve të tjerë të mundshëm.
37. Më 3 gusht 2012, hetuesit kanë dorëzuar një raport, i cili ka përshkruar të gjitha masat hetimore që ishin ndërmarrë. Bazuar në këtë raport, prokurori i EULEX-it ka ardhur në përfundim se nuk ishte e mundur të identifikoj ndonjë të dyshuar të përfshirë në incident. Prandaj, prokurori vendosi që mos të vazhdoj ndonjë hetim penal në përputhje me nenin 208, par. 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Policia dhe palët e dëmtuara ishin njoftuar me kohë.

LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i përbashkët

38. Pjesët përkatëse të shkëputura të nenit 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje: Veprimi i Përbashkët), thotë si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk

iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programet për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbush Deklaratën e Misionit të përcaktuar në nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

- (a) **monitorojë, udhëzoj dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës** në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), **përderisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;**
- (b) **sigurojë ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë, duke përfshirë, sipas nevojës, në konsultim me autoritetet përkatëse civile ndërkombëtare në Kosovë, nëpërmjet ndryshimit apo anulimit të vendimeve operationale të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës;**
- (d) **sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimin të organizuar, korrupsionit, krimin ndëretnik, krimin financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;**
- (h) **marrë përsipër përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur apo në përkrahje të autoriteteve kompetente të Kosovës, për të siguruar ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik dhe të sigurisë, në konsultim me agjencitë përkatëse të Këshillit; dhe**
- (i) **sigurojë që të gjitha veprimtaritë e saj përfillin standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.**

Ligji mbi kompetencat

39. Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (nr. 03/L-053, më tutje: Ligji mbi kompetencat) dhe më saktësisht nenet 7, 8 dhe 17 të tij, rregullojnë përfshirjen dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe

prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Neni 7 Kompetenca e përgjithshme e prokurorëve të EULEX-it

7.1 Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetenca dhe përgjegjësi që të ushtrojnë funksionet e tyre, përfshirë këtu kompetencat për të kryer hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetimet penale apo procedurat e lëndëve të reja dhe atyre të pazgjidhura në kuadër të PSRK-së apo në kuadër të zyrave prokuroriale ku ai apo ajo është e caktuar nga kryeprokurori i EULEX-it dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

Neni 8 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

8.1 Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të veçantë të PSRK-së sipas ligjit mbi themelimin e ZPSK-së, dhe krimet, përfshirë këtu tentimin dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krime, të paraqitura në të gjitha pikat e paragrafit 3 të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 17

17.1 Gjatë kohëzgjatjes së EULEX-it KOSOVË në Kosovë, policia e EULEX-it do të ketë kompetencë që të ushtrojë kompetencat ashtu siç njihen me anë të ligjit në fuqi për policinë e Kosovës dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga shefi i EULEX-it KOSOVË.

II. ANKESAT

40. Ankesat kanë të bëjnë me dy incidente të ndryshme, të cilat janë të lidhura me festimet e Vidovdanit më 28 qershor 2012.
41. Ankuesit mbështeten në një numër të të drejtave të mbrojtura, duke përfshirë të drejtën për jetën (p.sh. neni 2 KEDNj; neni 6 KNDCP), të drejtën për të mos u nënshtruar trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (p.sh. nenin 3 KEDNj; neni 7 KNDCP), e drejta për liri dhe siguri (neni 5 KEDNj; neni 9 KNDCP), të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 KEDNj; nenet 17/23 KNDCP), e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 9 KEDNj; nenet 18/19 KNDCP), liria e shprehjes (neni 10 KEDNj; neni 19 KNDCP), e drejta e lirisë së tubimit dhe bashkimit (neni 11 KEDNj; neni 21/22 KNDCP), e drejta për një ankim efektiv (neni 13 KEDNj; neni 2 KNDCP), ndalimi i diskriminimit (neni 14 KEDNj; neni 26/27 KNDCP).

III. LIGJI

42. I mbetet Panelit të përcaktoj karakterin ligjor të ankesave që duhet të shqyrtohen. Paneli do të shqyrtojë këto lëndë në bazë të dispozitave të mëposhtme: e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 KEDNj; neni 17 KNDCP); drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 9 KEDNj; nenet 18 dhe 19 të KNDCP);

drejtën e lirisë së tubimit dhe shoqërimit (neni 11 KEDNj; nenet 21 dhe 22 KNDCP) dhe e drejta për një ankim efektiv (neni 13 KEDNj; neni 2 KNDCP).

43. Para se t'ju kthehet thelbit të ankesave të bëra nga aplikantët, Paneli së pari duhet të përcaktoj fushëveprimin e juridiksionit të saj për qëllime të këtyre lëndëve.
44. Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, përfshirë veprimet e detyruara nga policia e EULEX-it.
45. Paneli është i mendimit se fakti i thjeshtë që operacioni policor në atë ditë ishte udhëhequr nga dhe ka hyrë brenda përgjegjësisë parësore të PK-së nuk e përjashton faktin se EULEX-i mund të mbahet përgjegjës për veprimet e veta apo dështimet për atë sa ato kanë ndikuar në ushtrimin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Në veçanti, Paneli do të konsiderojë nëse ndonjë e metë që i ngarkohet EULEX-it në përgatitjen ose kryerjen e operacionit të Vidovdanit më 28 qershor 2012 mund të ketë shkelur apo kontribuar në shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesve.
46. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konstatuar, në kontekst të lëndëve që i janë parashtruar asaj sipas neneve 2 (e drejta për jetë] apo neni 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës) i KEDNj-së se *"vështirësitë që përfshihen në detyrat policore në shoqëritë moderne, paparashikueshmëria e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operative të cilat duhet të bëhen në aspektin e prioriteteve dhe burimeve, [...] një detyrim [për të mbrojtur jetën] duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk imponon një barrë të pamundur apo joproporcionale mbi autoritetet. Prandaj, jo çdo pretendim për rrezikim të jetës mund t'i obligoj autoritetet rreth ndonjë kërkesë të Konventës që të ndërmerren masa operative për të parandaluar që mos të konkretizohet ai rrezik"* (shih Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 tetor 1998, § 116, raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998 VIII). Gjithashtu, kur forcat e policisë përballen me situata të trazirave ose të dhunës që kanë mundësi të marrin zhvillime të paparashikueshme, nuk duhet që të ngarkohen me barrë të pamundur (shih *Makaratzis kundër Greqisë [GC]*, nr. 50385/99, § 69, GJEDNj 2004-XI, dhe *Zelilof kundër Greqisë*, nr. 17060/03, § 48, 24 maj 2007). Gjykata më tej ka konstatuar se *"policisë duhet t'i jepet një shkallë të diskrecionit në marrjen e vendimeve operationale. Këto vendime të tilla janë pothuajse gjithmonë të komplikuara, ndërsa policia që ka qasje në informata dhe inteligjencë që nuk janë në dispozicion për publikun e gjerë, zakonisht do të jetë në pozitë më të mirë për t'i marrë ato"* (P.F dhe E.F kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikimi, (vendimi), nr. 28326/09, 23 nëntor 2010, § 41, *mutatis mutandis*).
47. Paneli është i mendimit se asgjë prej fakteve të vërtetuara në këtë lëndë që i kanë paraqitur ankuesit nuk ngreh në pah çështjet sipas

neneve 2 ose 3 të Konventës. Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e festimeve të Vidovdanit më 28 qershor 2012, e cila është krijuar që një kohë të gjatë, numrin e madh të njerëzve të cilët në përgjithësi kanë marrë pjesë në atë festime, tensionet politike dhe etnike për të cilat ajo mund të rriten në një mjedisin të paqëndrueshëm sigurie në Kosovë, Paneli beson se EULEX-i e dinte ose duhej ta ketë ditur para festimeve të Vidovdanit të vitit 2012 për praninë e një rreziku real dhe të drejtpërdrejtë të shkëljes së të drejtave të njeriut që kanë ndodhur gjatë këtyre ngjarjeve (shih, p.sh. *P.F dhe E.F kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të cituar më lart , §. 37).

48. Paneli në lidhje me këtë vëren se EULEX-i në parashtrimet e tij nuk e ka kontestuar as rëndësinë e ngjarjeve të përvitshme të Vidovdanit e as nuk ka qenë në dijeni për rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë që lidhen me të.
49. Paneli vëren argumentin e EULEX-it se në ushtrimin e përgjegjësisë së EULEX-it si një "reagues i dytë" do të ishte e nevojshme të ndërhyhet vetëm nëse dhe kur ishte kërkuar nga PK-ja. Paneli nuk ka qenë në gjendje të identifikojë ndonjë bazë ligjore që do të kufizojnë detyrimin e EULEX-it për të ndërhyrë si një "reagues i dytë" dhe se pretendimi i EULEX-it se një detyrim i tillë për të reaguar do të lind vetëm në bazë të kërkesës së autoriteteve të Kosovës.

Në vend të kësaj, Paneli vëren gjuhën e qartë dhe të kuptueshme të Veprimit të Përbashkët në nenin 3 (b) i cili përcakton një detyrim për EULEX-in për të "siguruar ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë, duke përfshirë sipas nevojës në konsultim me autoritetet përkatëse civile ndërkombëtare në Kosovë, nëpërmjet kthimit ose anulimit të vendimeve operacionale të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës" (shih paragrafin 38 më sipër). Kjo qasje më tej është mbështetur nga paragrafi (h) i të njëjtit nen që thotë se EULEX-i do të "marrë përsipër përgjegjësi të tjera, në mënyrë të pavarur apo në përkrahje të autoriteteve kompetente të Kosovës, për të siguruar ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe të sigurisë "(shih paragrafin 38 më sipër). Më tej, nëse pranohet argumenti i EULEX-it, ajo do të ishte në kundërshtim me detyrimet e natyrshme të EULEX-it për të mbrojtur të drejtat e njeriut, pasi ajo me gjasë do të zvogëlonte efikasitetin e asaj mbrojtjeje.

50. Paneli pranon se duke marrë parasysh mandatin e kufizuar ekzekutiv të EULEX-it, EULEX-i nuk mund të mbahet përgjegjës për dështimin e garantimit të mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut si të tillë në Kosovë dhe se një barrë e pamundur apo jopoprcionale sa i përket punës së policisë nuk mund t'i ngarkohet Misionit. Megjithatë, Paneli vëren se është detyrim i EULEX-it sipas Veprimit të Përbashkët të Këshillit për të siguarur që aktivitetet e saj duhet të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (shih nenin 3 (i), Këshilli i Përbashkët i Veprimit 2008/124/CFSP; shih paragrafin 38 më sipër). Prandaj EULEX-i do të kërkohej të ndërhynte për të mbrojtur të drejtat e njeriut kudo që e di ose që duhet ta di në

kohën e rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë që ndonjë shkelje mund të ndodhë në qoftë se ai nuk do të ndërhynte (shih p.sh. *Gjorgjeviq kundër Kroacisë*, nr. 41526/10, § 138-139, KEDNj 2012 dhe referencat e cituara aty; *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, § 16). Natyra e reagimit duhet t'i përshtatet rrethanave dhe nga ana tjetër varet se cila e drejtë apo të drejta kanë qenë të rrezikuara dhe varet rreth seriozitetit të kërcënimeve ndaj atyre të drejtave (shih vendimin e Panelit në *Kahrs kundër EULEX-it*, nr. 2012-16, § 31).

51. Rrjedhimisht, Paneli do të shqyrtojë nëse, në rastin konkret, veprimet ose mosveprimet e EULEX-it, për aq kohë sa ato kanë prekur ankuesit në kontekstin e operacionit policor më 28 qershor 2012, kanë qenë në përputhje me mandatin ekzekutiv të EULEX-it.
52. Paneli vëren se ankuesit B, C dhe D kanë marrë pjesë në shërbesën përkujtimor në Gazimestan, në ditën në fjalë. Gjatë kthimit nga Gazimestani, ishin hedhur gurë dhe koktejt molotovi nga djem të rinj mbi autobusët në të cilët ata po udhëtonin, që ka rezultuar me thyerjen e dritareve të autobusëve. Ankuesit B dhe C pohojnë se dy udhëtarë në autobusin e tyre ishin plagosur gjatë sulmit. Pretendohet se PK-ja po i shoqëronte autobusët, mirëpo nuk kishte arritur t'i mbroj. Më tej, ankuesi B kishte humbur vetëdijen pas mbërritjes në Graçanicë për shkak të stresit të shkaktuar nga këto sulme të dyshuara. Më pas ai/ajo ishte dërguar në një spital për kontroll mjekësor.
53. Paneli vëren se duke marrë pjesë në festimet në Gazimestan ankuesit kanë kërkuar që të ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e tubimit dhe të drejtën e tyre për lirinë e ndërgjegjes. Ndonëse ata nuk ishin penguar në pjesëmarrjen e kësaj ngjarje, më pas ata ishin viktimë të një sulmi të dhunshëm nga persona privat kundër autobusit në të cilin ata po udhëtonin. Pasi që në këtë mënyrë integriteti trupor i tyre ishte kërcënuar, Paneli do të shqyrtojë ankesat në lidhje me to në kontekstin e të drejtës së tyre për të respektuar jetën e tyre private.
54. Paneli së pari vënë re se faktet nuk kontestohen nga palët.
55. Paneli thekson se "*ndonjë* demonstrim mund të zemëroj apo fyej personat që janë kundër ideve apo kërkesave që ai demonstrim po kërkon t'i promovoj. Megjithatë pjesëmarrësit duhet të jetë në gjendje të mbajë demonstratën pa pasur frikë se ata do t'i nënshtrohen dhunës fizike nga kundërshtarët e tyre; një frikë e tillë do të kishte mundësi të pengonte tubimet apo grupet e tjera që mbështesin idetë e përbashkëta apo interesat për t'i shprehur haptas mendimet e tyre rreth çështjeve tejet të diskutueshme që prekin komunitetin. Prandaj liria e vërtetë, efektive e tubimit paqësor nuk mund të zvogëlohet në një detyrë të thjeshtë nga ana e shtetit që mos të ndërhyrë: një konceptim tërësisht negativ nuk do të ishte në përputhje me objektivin dhe qëllimin e nenit 11 (n. 11). Ashtu si neni 8 (n. 8), neni 11 (n. 11) ndonjëherë kërkon që do të ndërmerren masa pozitive, madje edhe

në sferën e marrëdhënieve midis individëve, në qoftë se është e nevojshme (shih, *mutatis mutandis*, X dhe Y kundër Holandës, gjykimi i datës 26 mars 1985, Seria A nr. 91, fq. 11, § 23)". (shih, *Plattform "Ärzte für das Leben"* kundër Austrisë, 21 qershor 1988, § 32, Seria A nr. 139). Përderisa është nën jurisprudencën e GjEDNj-së ajo është detyrë e autoriteteve publike që të ndërmarrin masa të arsyeshme dhe të duhura në lidhje me demonstratat e ligjshme në mënyrë që të sigurohet sjellja e tyre paqësore dhe siguria e të gjithë qytetarëve, ata nuk mund të garantojnë këtë absolutisht dhe ata kanë një kufi të gjerë të lirisë për të bërë zgjedhjen e mënyrave që do t'i përdorin. Në lidhje me këtë, detyrimi ku ata hyjnë në bazë të nenit 11 të Konventës është një detyrim për masat që duhen ndërmarrë dhe jo për rezultatet që duhen arritur (shih *Plattform "Ärzte für das Leben"* kundër Austrisë, cituar më lartë, § 34; *Oya Ataman kundër Turqisë*, nr. 74552/01, § 35, KEDNj 2006-XIII; *Ouranio Toxo dhe të tjerët kundër Greqisë*, nr. 74989/01, § 37, KEDNj-2005 X (ekstrakt) dhe *Protopapa kundër Turqisë*, nr. 16084/90, § 108, 24 shkurt 2009). Megjithatë, është e rëndësishme që masat parandaluese të sigurisë, siç janë për shembull prania e shërbimeve të ndihmës së parë në demonstrata, të ndërmerren për të garantuar sjellje të qetë të çfarëdo tubimi, mbledhje ose ngjarje të tjera, qofshin politike, kulturore ose të një natyre tjetër (shih *Oya Ataman kundër Turqisë*, të cituar më lartë, § 39).

56. Më tutje përsëritet se përderisa ata që zgjedhin të ushtrojnë lirinë e tyre për të manifestuar ndërgjegjen apo fenë e tyre nuk mund të presin mjaft që të përjashtohen prej të gjitha kritikave, përgjegjësia e autoriteteve publike mund të vlej aty ku janë kundërshtuar ose mohuar besimet e tyre në një mënyrë e cila i pengon ata të cilët i kanë këto besime të ushtrojnë lirinë e tyre për të mbajtur ose shprehur ato. Në raste të tilla autoritetet mund të thirren për të siguruar gëzimin paqësor të së drejtës së garantuar me nenin 9 të bartësve të këtyre besimeve (shih, *mutatis mutandis*, *Otto-Preminger-Institut kundër Austrisë*, 20 shtator 1994, § 47, Seria A nr. 295-A; *Öllinger kundër Austrisë*, nr. 76900/01, § 39, KEDNj 2006-IX).
57. Në rastin konkret, autobusi i ankuesve ishte sulmuar nga persona privat. Nuk është treguar apo argumentuar se policia e EULEX-it ishte e pranishme në vendin e ngjarjes për të cilën ka të bëjë ankesa. Megjithatë është pikërisht mungesa e policisë së EULEX-it në vendngjarje dhe mungesa e parashikimit të duhur që ka ngritur shqetësimin. Paneli vëren se EULEX-i ka ofruar shifra kundërthënëse lidhur me numrin e zyrtarëve të EULEX-it të cilët ishin në detyrë në ngjarjet e Vidovdanit dhe po ashtu vendndodhjen e tyre.
58. Nuk është treguar se pikat kufitare të kufirit administrativ, rrugët dhe kryqëzimet rrugore përkatëse ishin të siguruara siç duhet dhe se autokolona e automjeteve që udhëtonte përgjatë këtyre rrugëve ishte siguruar me mbrojtje të duhur. Përderisa hollësitë operative që kanë të bëjnë me këtë çështje u ishin lënë autoriteteve kompetente të EULEX-it, Paneli vëren mungesën e dokumentacionit të hollësishëm operacional dhe plan emergjent, të cilat sugjerojnë se EULEX-i nuk ka

bërë përpjekje të duhura në bashkëpunim me PK-në që të siguroj që rrugët që ka të ngjarë se do të përdoren nga pjesëmarrësit ishin identifikuar siç duhet dhe siguruar në mënyrë që të parandalohen dhe dekurajohen sulmet nga persona privat, të tilla si ato që kanë ndodhur në rastin konkret.

59. Ndodhja e incidenteve të dhunës në ditën në fjalë, e cila nuk kontestohet nga palët, sugjeron se numri i policëve të pozicionuar të EULEX-it ishte i pamjaftueshëm për t'ju qasur përgjegjësive të mandatit ekzekutiv të EULEX-it sa i përket tubimit të madh të pjesëmarrësve/festuesve të cilët ka mundur me gjasë që të kundërshtohen apo pengohen nga elemente të caktuara apo persona të popullatës së Kosovës.
60. Nën rrethana të tilla, Paneli është i mendimit se EULEX-i duhet të ketë siguruar që një numër i mjaftueshëm i zyrtarëve policor të EULEX-it të ishin caktuar për të monitoruar ato ngjarje, që ata të vendoseshin në vendet kritike (p.sh. pikat e kalimit të kufirit administrativ, rrugët për dhe nga ato pikë të kalimit dhe në vende të identifikuar të tubimit, si dhe në Gazimestan etj.), që ata të kishin të gjitha mjetet e nevojshme në dispozicion të tyre, për shembull në aspektin e transportit dhe komunikimit, si dhe mjete për përmbarim, për të kryer funksionet e tyre në mënyrë efektive dhe se atyre t'ju ishin dhënë porosi dhe udhëzime të qarta për atë se kur dhe në çfarë rrethanash ju kërkohet dhe pritej nga ta që të ndërhyjnë për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë parandalimin e sjelljeve frikësuese apo agresive nga persona privat.
61. Pamjaftueshmëria e burimeve të caktuara nga EULEX-i për këtë operacion ka kontribuar që tre ankuesve t'ju mohohet gëzimi i plotë dhe efektiv i së drejtës së tyre për respektim të jetës private, lirisë së tyre për tubim, si dhe të drejtës së tyre për të ushtruar fenë e tyre në mënyrë të sigurt dhe pa pengesa të panevojshme.
62. Sa i përket ankuesit "A", ai ishte ndaluar nga zyrtarët e NjMRO-së para se të ishte në gjendje të arrinte në Gazimestan. Zyrtarët e kontrolluan dokumentet e tij të identifikimit, dokumentet e makinës dhe kontrolluan makinën e tij. Ai u urdhërua të kthehej dhe u pengua që të udhëtonte drejt Gazimestanit për të marrë pjesë në ngjarjen që ai dëshironte të merrte pjesë. Më pas, ai ka pohuar se ishte sulmuar fizikisht nga policia e NjMRO-së.
63. Ashtu si në rastin e ankuesve "B", "C" dhe "D", nuk është treguar apo argumentuar se zyrtarët e policisë së EULEX-it ishin të pranishëm në vendin e ngjarjes së incidentit të dyshuar. Prandaj nuk është vërtetuar në bazë të materialit në Panel se EULEX-i është drejtpërdrejtë përgjegjës lidhur me çfarëdo dështimi për t'ju qasur apo për të penguar incidentin në fjalë.
64. Paneli gjithashtu vëren parashtrimet e ShM-së se operacioni ishte udhëhequr nga PK-ja. Përderisa ky fakt nuk kontestohet, EULEX-i ka

mbajtur përgjegjësinë e vet për të siguruar se përfshirja e tij në këto ngjarje dhe operacione ka qenë e pranuar, në pajtim dhe në përputhje me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut. Në veçanti, nuk është treguar se janë ndërmarrë hapa të duhura për të siguruar bashkërendimin me PK-në, në mënyrë që të sigurohet mbrojtje efektive e pjesëmarrësve kundër veprimeve të papërshtatshme apo të tepruara, duke përfshirë edhe shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga pjesëtarët e PK-së. Më tej, nuk është treguar se autoritetet e EULEX-it ju kanë dhënë udhëzime të qarta operative zyrtarëve të policisë së EULEX-it në terren, veçanërisht se në çfarë rrethanash këtyre do t'ju kërkohet të ndërhyjnë për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut.

65. Paneli konstaton se, ngjashëm ndaj ankuesve të tjerë, si rezultat i burimeve të pamjaftueshme të caktuara për operacionin e Vidovdanit nga EULEX-i me qëllim të sigurimit të respektimit të të drejtave të njeriut, jo më pak nga ana e PK-së, ankuesit "A" ju ishte mohuar gëzimi i plotë dhe efektiv i të drejtës së tij për respektimin e jetës private, lirisë së tij për tubim, si dhe të drejtës së tij për të ushtruar fenë e tij në mënyrë të sigurt dhe pa pengesa të panevojshme.
66. Paneli më tutje vëren se pas incidenteve të Vidovdanit të vitit 2012 ishin ndërmarrë hapa të caktuar hetimor me qëllim të vërtetimit të rrethanave të një sulmi specifik ndaj autobusëve që po transportonin pjesëmarrësit e atyre ngjarjeve. Së pari, Paneli vëren se përderisa këto hapa hetimor në këto aspekte që lidhen disi me ngjarjet që përbëjnë bazën e tri prej ankesave (p.sh. lëndët e ankuesve "B", "C" dhe "D"), këto përpjekje hetimore nuk kanë adresuar shumicën e incidenteve të shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut të cekura në ankesa. Në veçanti, Paneli vëren mungesën e ndonjë reference në parashtrësit e EULEX-it lidhur me ndonjë përpjekje për të hetuar sjelljen e PK-së në këto incidente. Ai informacion nuk tregon qoftë edhe nëse ky hetim ka hetuar sjelljen e zyrtarëve të EULEX-it dhe nëse ata kishin përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në këtë drejtim. Gjithashtu Paneli vëren se bazuar në informacionin që ju ishte dhënë, ngjarjet që përbëjnë bazën e ankesës "A" nuk kishin qenë subjekt i ndonjë hetimi.
67. Duke pasur parasysh shqyrtimet e mësipërme, Paneli konkludon se në bazë të materialit që ju ishte dorëzuar, EULEX-i ka dështuar të tregoj që kishte kryer ndonjë hetim të plotë dhe të duhur rreth dyshimeve të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Kjo ka rezultuar që ankuesve "A", "B", "C" dhe "D" t'ju mohohet mjete i duhur juridik lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

1. *Konsideron se ka pasur shkelje të neneve 8, 9, 11 dhe 13 të KEDNj-së, si dhe të neneve 17, 18, 21, 22 dhe 2 të KNDCP në lidhje me të gjithë katër ankuesit;*

2. *Gjen* të përshtatshme, në bazë të gjetjeve të tij të mësipërme të faktit dhe ligjit, që t'i ofroj rekomandimet e mëposhtme ShM-së sipas rregullës 34 të rregullores së vet të punës:

- i. Që ShM të pranoj se të drejtat themelore të ankuesve janë shkelur nga EULEX-i.
- ii. Që ShM të kërkoj nga të gjitha degët dhe organet përkatëse të EULEX-it, të cilat posedojnë informacione në lidhje me ngjarjet e Vidovdanit të vitit të kaluar, t'i ofrojnë atij një vështrim të plotë dhe komplet të veprimeve të EULEX-it gjatë këtyre ngjarjeve. Mbi këtë bazë, ShM të siguroj që çfarëdo informacioni në posedim të EULEX-it lidhur me shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut të kryera në këtë kontekst (përfshirë çfarëdo shkelje që i ngarkohet zyrtarëve të PK-së) t'i ofrohet autoriteteve kompetente të Kosovës për veprime dhe hetime vijuese. Nëse EULEX-i më vonë përcakton se rastet e tilla nuk ishin hetuar plotësisht dhe siç duhej, atëherë EULEX-i duhet ta konsideroj marrjen përsipër të përgjegjësisë të hetimit të këtyre rasteve.
- iii. ShM ftohet që të hetoj me autoritetet kompetente hetuese dhe prokuroriale në EULEX:
 - a) nëse mund të ndërmerren hapa të mëtejshëm hetimor në lidhje me incidentin që përfshin ankuesit "B", "C" dhe "D", dhe
 - b) nëse rasti që lidhet me ankuesin "A" është duke u hetuar nga autoritetet kompetente të Kosovës dhe, nëse jo, a duhet që kjo të hetohet nga EULEX-i.

Paneli fton ShM t'i informoj ankuesit drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve kompetente hetimore të EULEX-it rreth rezultatit të këtyre hetimeve. Ankuesit janë të lirë të raportojnë tek Paneli lidhur me çfarëdo çështje të pazgjidhura kur ata të kontaktohen nga EULEX-i.

- iv. Lidhur me planifikimin e përfshirjes së EULEX-it në festimet e ardhshme më 28 qershor 2013, ShM të siguroj që autoritetet kompetente të EULEX-it:
 - a) të kryejnë një vlerësim të rrezikut me qëllim të krijimit dhe identifikimit të burimeve të mundshme të rreziqeve ndaj mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të pjesëmarrësve gjatë këtyre festimeve të Vidovdanit. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente të EULEX-it t'i referohen dhe të marrin mësim nga lëshimet e identifikuara gjatë operacionit në Vidovdan në qershor të vitit 2012, ashtu siç është shënuar në këtë vendim;
 - b) t'i dorëzojnë ShM një plan të hollësishëm në lidhje me përfshirjen e EULEX-it në festimet e ardhshme të Vidovdanit më 28 qershor 2013. Një plan i tillë të përfshijë një përshkrim të hollësishëm të mjeteve dhe burimeve të

nevojshme për të siguruar që zyrtarët e EULEX-it të kryejnë përgjegjësitë e mandatit të tyre ekzekutiv në mënyrë efektive, në veçanti lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut të pjesëmarrësve në këto ngjarje. Kjo do të përfshijë, nëse nevojitet, opsionin që zyrtarët e EULEX-it të kërkojnë përforsime. Ky plan gjithashtu të përfshijë mjete të duhura të komunikimit dhe transportit për të siguruar se ndërhyrja e shpejtë është e mundur atëherë kur është e nevojshme për të parandaluar apo për t'i dhënë fund shkeljeve të të drejtave të njeriut;

- c) të sigurojnë bashkërendim të duhur midis misionit të EULEX-it në njërin anë dhe PK-së dhe autoriteteve kompetente të Kosovës në anën tjetër, në mënyrë që të ketë mbrojtje efektive të pjesëmarrësve në këto ngjarje. Gjithashtu EULEX-i të siguroj që zyrtarët e PK-së të përfshirë në këto çështje të jenë tërësisht të vetëdijshëm se dhuna ndaj pjesëmarrësve nuk do të tolerohet dhe se do të vendosen mekanizma të përgjegjësive për t'i ndëshkuar shkelësit;
- d) të caktojnë për këtë detyrë një numër të mjaftueshëm të zyrtarëve të EULEX-it në përputhje me rëndësinë e këtyre ngjarjeve të Vidovdanit dhe në përputhje me rrezikun e mundshëm të shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- e) të ofrojnë udhëzime dhe porosi të qarta për të gjithë zyrtarët e policisë të EULEX-it të përfshirë në këtë operacion, në veçanti në lidhje me rrethanat në të cilat atyre do t'ju kërkohej që të ndërhyjnë për të mbrojtur të drejtat e njeriut të pjesëmarrësve.

- v. Sa i përket hetimit dhe raportimit të mundshëm të sjelljes së pahijshme, ShM po ashtu të siguroj që zyrtarët e EULEX-it të përfshirë në operacionin e Vidovdanit të regjistrojnë me kujdes secilin rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut, në të cilat ata mund të jenë dëshmitarë apo të cilat u raportohen atyre. Nga ana tjetër, EULEX-i të hetojë secilin prej këtyre incidenteve dhe/apo ta kaloj këtë informacion tek autoritetet kompetente hetimore të Kosovës, me qëllim që të sigurohet hetim efektiv i çfarëdo rasti të tillë.

Ftohet ShM të njoftoj Panelin rreth masave që i ka ndërmarrë në lidhje me këtë vendim deri më 2 gusht 2013.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese